

Qershor 2017

EVN ZHURNAL

Gazeta për partnerët
dhe bashkëpunëtorët

ENERGJIA QË JU NEVOJITET!



Të nderuar konsumatorë,

Para jush është numri i parë i "EVN Zhurnal" që besojmë se do të sjellë energji të re në bashkëpunimin tonë të suksesshëm, por edhe do t'ju tregojë ndodhitë e tregut të energjisë elektrike. "EVN Zhurnal" do të botohet katër herë në vit. Ajo do t'i përcjellë lajmet nga puna e EVN Elektrofuornizimi që i interesojnë konsumatorët tanë, informacione mbi produktet dhe shërbimet në dispozicion të tyre, por edhe shqyrtimi i trendëve më të reja në segmentin e furnizimit me energji elektrike. Gjithashtu do të japim këshilla për menaxhment më të mirë energjetik në kompanitë dhe institucionet. Sinqerisht besojmë se "EVN Zhurnal" do të jetë një tekst i dobishëm dhe i këndshëm.

Kjo gazetë është reflektim i orientimit tonë ndaj konsumatorëve si një përcaktim strategjik. Në fokusin e këtij përcaktimi të kompanisë është dëshira për të siguruar një furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike dhe shërbim cilësor, dhe kjo është e mundur vetëm në qoftë se ju dispononi angazhimin e një ekipi kompetent dhe të përkushtuar, i



mbështetur me përvojë ndërkombëtare dhe njohuri të tërësishme të industrisë, që është i aftë dhe i zellshëm për t'iu përgjigjur të gjitha nevojave të konsumatorëve.

Ajo që e bën ekipin e EVN Maqedoni Elektrofuornizimi të veçantë është gatishmëria për t'iu përgjigjur nevojave specifike të çdo

konsumatori. Konsumatorët që kishim kënaqësinë për t'i shërbyer, dinë se për çdo çështje lidhur me furnizimin me energji elektrike vetëm duhet ta kontaktojnë menaxherin e tyre për klientë dhe do të marrin përgjigje cilësore dhe zgjidhje në një afat më të shkurtër të mundshëm. Si një ekip, ne i dimë nevojat dhe specifikat e biznesit të kon-

sumatorëve tanë dhe jemi të gatshëm për të ofruar produkte dhe shërbime sipas nevojave për secilin prej tyre.

Si anëtare e Grupacionit të EVN, kemi qasje në një përvojë të rëndësishme ndërkombëtare. Njohuria nga tregjet në të cilat është prezent Grupacioni EVN, sidomos në segmentin e furnizimit me energji elektrike, është e vlefshme në punën tonë të përditshme dhe në shërbimin e konsumatorëve. Rregullisht ne e vendosim know-how në funksion të konsumatorëve, por e bëjmë të disponueshëm edhe më gjerë në mesin e ekspertëve dhe të shoqërisë në përgjithësi.

Ju ftojme që t'i zbuloni përmbajtjet e gazetës së parë "EVN Zhurnal".

Me respekt,

Markus Brandshteter
Menaxher në EVN Maqedoni
Elektrofuornizimi SHPKNJP

Juliana Zaovska Vidinovski
Menaxher në EVN Maqedoni
Elektrofuornizimi SHPKNJP

Përmbajtja 06/17

03 EVN Maqedoni Elektrofuornizimi - shërbimi superior ndaj konsumatorëve

04 Struktura e tregut të energjisë elektrike në Republikën e Maqedonisë

05 Liberalizimi i tregut të energjisë elektrike - një fazë e re e zhvillimit

06 Menaxhmenti energjetik - nevojë dhe kërkesë e botës bashkëkohore

07 Intervistë me **Inxh. Ginter Brambuk**, Zëvendës-kryetar për çështje rregullative në Njësinë afariste të Evropës Juglindore, EVN AG

08 Përvoja e konsumatorëve të kënaqur

08 Ueb-faqja e re e internetit për avancimin e përvojës së konsumatorëve



EVN Maqedoni Elektrofurnizimi - shërbimi superior ndaj konsumatorëve

EVN Maqedoni Elektrofurnizimi është themeluar në vitin 2011 dhe me kontributin e saj në zhvillimin e tregut të liberalizuar të kohës së fundit, është një nga furnizuesit më të njohur të energjisë elektrike në Maqedoni. Si pjesë e një grupacioni të madh që u shërben rreth 4.5 milion konsumatorësh, EVN është kompani që ka përvojë më të madhe në furnizimin me energji elektrike në Evropën Juglindore. Falë ekipit të saj shumë të motivuar dhe njohurive të eksperteve në fushën e furnizimit me energji, kompania u ofron shërbime të sigurta dhe të cilësisë së lartë konsumatorëve të saj, duke u mundësuar një kontribut të qëndrueshëm për sigurinë e biznesit të tyre dhe punën e tyre cilësore.

Me qëllim që të plotësohen pritjet e konsumatorëve, EVN Maqedoni Elektrofurnizimi ka menaxher të përgjegjshëm për klientë kryesorë për çdo konsumator potencial sipas rajonit ku gjendet ose specifikave të biznesit të tij. Si një vlerë e shtuar për konsumatorët, kompania vazhdimisht punon në përmirësimin e shërbimeve të saj këshilluese dhe ofertat që janë krijuar sipas nevojave të konsumatorëve përkatësisht sipas nevojave të tyre individuale. Përveç kësaj, menaxherët e dedikuar për klientë kryesorë janë trajnuar të japin mbështetje, t'i zbatojnë dhe të menaxhojnë me të gjitha kërkesat lidhur me energjinë elektrike, që kanë të bëjnë me çështjet dhe shërbimet që i japin institucionet tjera relevante dhe organet e tregut.

Menaxherët për klientë kryesorë në çdo kohë në dispozicion e kanë përvojën dhe njohuritë



e ekepeve për mbështetje, si lokale ashtu edhe ndërkombëtare, në kuadër të Grupacionit EVN. Gjegjesisht, me zgjedhjen e EVN Elektrofurnizimi, konsumatorët nuk fitojnë thjeshtë një furnizues të energjisë elektrike, por edhe një partner i cili ndjek nevojat e tyre dhe gjen zgjidhje veçanërisht të dizajnuara sipas nevojave të kompanisë. Në atë mënyrë konsumatorët mund të jenë të sigurt se ajo që është e rekomanduar nga menaxherët tanë për klientë kryesorë, është rezultat i analizës serioze të profilit të konsumit dhe të nevojave.

Bashkëpunimi me EVN Maqedoni Elektrofurnizimi ndihmon konsumatorëve ta optimizojnë konsumin e energjisë elektrike dhe për të arritur një efikasitet më të madh energjetik. Përveç kësaj, EVN Maqedoni Elektrofurnizimi përpiqet që të sigurojë kombinimin optimal të stabilitetit dhe fleksibilitetit në biznes dhe në marrëdhëniet kontraktuale me qëllim që t'ju ndihmojë kushteve të tyre dhe të harmonizohet me kushtet e ndryshueshme të tregut.

Kompanitë gjithmonë mund të mbështeten në EVN Maqedoni Elektrofurnizimi si një partner i qëndrueshëm dhe i besueshëm që është në dispozicion të tyre dhe për biznesin e tyre në çdo kohë, dhe është superior në përmbushjen e çdo kërkesë. Kompania ka për qëllim të sigurojë përfitime që sjellin vlera për konsumatorët, vlera që i mbështet në një periudhë afatgjatë në krijimin e të ardhmes së qëndrueshme dhe të suksesshme që i tejkalon përfitimet momentale financiare.




Struktura e tregut të energjisë elektrike në Republikën e Maqedonisë

Në vitin 2005 Republika e Maqedonisë e nënshkroi Memorandumin e Athinës dhe vitin e ardhshëm ai u ratifikua në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Ky dokument i rëndësishëm ishte bazë për krijimin e një tregu të përbashkët energjetik në Evropën Juglindore, sipas standardeve të Bashkimit Evropian, që shënoi fillimin e transformimit të plotë të tregut energjetik të Maqedonisë.

Pasi që u krijuan parakushtet e mëparshme dhe ishte sjellë kornizë e përshtatshme ligjore që ishte në përputhje me legjislacionin evropian të fushës në vitin 2007, konsumatorët e mëdhenj që kanë qenë të lidhur në rrjetin përçues të Sistemit Operatorit Elektropërçues të Maqedonisë (MEPSO) ishin kompanitë e para që kanë marrë të drejtën për të u furnizuar me energji elektrike në tregun e lirë. Sipas planit, liberalizimi i tregut të përgjithshëm duhej të ndodhte gradualisht për të shmangur goditjet e çmimeve, sidomos për qytetarët që paguajnë edhe sot çmimin e subvencionuar të energjisë elektrike, shumë nën mesataren rajonale dhe evropiane. Dalimin e çmimit në favor të qytetarëve sipas modelit aktual tarifor e kompensojnë kompanitë. Me liberalizimin e plotë ky model do të zëvendësohet plotësisht.

Duke filluar me këtë proces në Maqedoni funksionon një treg i rregulluar i energjisë elektrike dhe një treg i liberalizuar i energjisë elektrike, ku sipas Planit të veprimit për gjeneralisim në një periudhë të ndryshme kohore rritet numri i subjekteve, të cilat nga

Tregu i rregulluar



një treg i rregulluar kalojnë në tregun e liberalizuar. Në tregun e rregulluar në Republikën e Maqedonisë, kompania Elektranat e Maqedonisë (ELEM) ka obligim të prodhojë energji elektrike dhe ta shesë të njëjtën me një çmim të rregulluar dhe në përputhje me kontratat dhe dispozitat e rregulluara. Operatori i Sistemit të Transmetimit të Maqedonisë ose Operatori i sistemit të elektrotransmetimit (OSET) dhe Operatori i Tregut të Energjisë Elektrike (OTEE) ka detyrë të kryejë transmetimin e energjisë elektrike dhe ta menaxhojë sistemin elektorenergjetik të Republikës së Maqedonisë dhe është përgjegjës për punën e sistemit, mirëmbajtjen e tij, zhvillimin dhe lidhjen me sistemet e transmetimit të energjisë elektrike të vendeve fqinje. Në të njëjtën kohë OTEE është obliguar që të organizojë dhe menaxhojë tregun e energjisë elektrike në vend. Pasi ELEM e transmeton energjinë elektrike të Operatorit të sistemit elektrodistributiv, më

tutje energjinë elektrike e merr EVN Elektrodistribuimi përkatësisht Operatori i sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike (OSSH) dhe Furnizuesit e energjisë elektrike të instancës së fundit. EVN Elektrodistribuimi është përgjegjës për funksionimin e sistemit, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e tij, dhe gjithashtu ka një obligim për të siguruar nevojat e energjisë elektrike të konsumatorëve. Të gjitha fazat e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe çmimeve për konsumatorët përfundimtarë përcaktohen nga Komisioni Rregullator i Energjetikës.


Në tregun e hapur të energjisë elektrike prodhuesit ofrojnë energjinë elektrike në treg të hapur në një bursë apo përmes marrëveshjeve të drejtpërdrejta bilaterale me furnizuesit. Në tregun e hapur, prodhuesit që prodhojnë energji të gjelbër ose kanë instalime me efikasitet të lartë kanë statusin e prodhuesve të privilegjuar, dhe kjo energji

ka një çmim më të lartë në treg për të stimuluar këtë lloj të prodhimit. Në bazë të kësaj, deri më datë 30.05.2017 e sollën vendimin cilit nga furnizuesve do t'ja besojnë sigurimin e energjisë për funksionim të pandërprerë të biznesit të tyre dhe nënshkruan kontratë për furnizim me energji elektrike. Ata të cilët nuk kanë nënshkruar kontratë, do të furnizohen nga furnizues të instancës së fundit.

EVN Elektrofurnizimi çdo ditë i plotëson nevojat e përditshme të energjisë elektrike të konsumatorëve të saj përmes shërbimit me cilësi të lartë dhe me çmime konkurruese, është partneri i vërtetë të kompanive në Republikën e Maqedonisë.

Tregu i lirë i energjisë elektrike monitorohet nga Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, që fokusohet në sigurimin e marrëdhënieve të drejta dhe konkurruese në treg në interes të konsumatorëve.

Tregu i hapur





Liberalizimi i tregut të energjisë elektrike - një fazë e re e zhvillimit

Në vazhdim është realizimi i fazës së re të procesit të liberalizimit të tregut të energjisë elektrike që prek një grup të ri, më të madh të kompanive. EVN Maqedoni Elektrofurnizimi, si një furnizues i licencuar dhe një kompani e përgjegjshme, lider në veprimtarinë e saj, në kohë i lajmëron të gjitha subjektet që potencialisht mund të preken nga ndryshimi i kushteve të tregut. Gjithashtu, ekipi i EVN Elektrofurnizimi është i hapur për të gjitha çështjet dhe informacionet shtesë në lidhje me procesin e liberalizimit dhe fazat që pasojnë, për të ndihmuar kompanitë e përfshira në sjelljen e vendimit më të mirë për biznesin e tyre. Liberalizimi, në aspektin praktik, do të thotë se kompania që në përputhje me

legjislationin hyn në grupin e kompanive që duhet të furnizohen me energji elektrike në tregun e lirë, do ta ketë të drejtën për të zgjedhur subjektin e biznesit, mbajtësin e licencës Furnizues i Energjisë Elektrike, do t'i sigurojë nevojat e saj të energjisë elektrike.

Sipas legjislationit, subjektet (kompanitë, institucionet, organizatat) fitojnë të drejtën që në tregun e lirë të furnizohen me energji elektrike në bazë të kriterëve të ndryshme. Liberalizimi si proces në Maqedoni filloi në vitin 2007, dhe në vitin 2014 në tregun e lirë të energjisë elektrike u furnizuan të gjitha kompanitë që kanë së paku 50 të punësuar dhe të ardhura të përgjithshme prej dhjetë milionë eurosh në vitin e kaluar. Fazat e


tjera sipas planit të veprimit të përcaktuar në Ligjin për Energetikë (neni 197) janë të lidhura me konsumin vjetor të energjisë elektrike dhe në bazë të këtij kriteri janë parashikuar 5 fazat e zbatimit të liberalizimit.

Siç shihet nga grafiku i treguar, deri më tani janë realizuar 3 faza të liberalizimit, ndërsa momentalisht në realizim e sipër është faza e katërt, kriteri i së cilës është kostoja në vitin 2016 që tejkalon 500 MWh.

Kompanitë që ka përbushur këtë kriter kanë marrë një njoftim zyrtar nga operatori i sistemit të shpërndarjes për marrjen e statusit të konsumatorit të kualifikuar, e pastaj kanë marrë edhe një

ofertë nga furnizuesit - pjesëmarrës të licencuar në treg. Në bazë të kësaj, deri më 30.05.2017 e kanë marrë vendimin se cilit prej furnizuesve do t'ia japin besimin që të sigurojë energjinë për funksionim të pandërprerë të biznesit të tyre dhe kanë nënshkruar një kontratë për furnizim me energji elektrike. Ata që nuk kanë nënshkruar kontratën do të furnizohen nga një furnizues i cili do të përcaktohet për ta në mënyrë shtesë.

Distribuími i energjisë elektrike në tregun e lirë, për kompanitë që plotësojnë kriterin e konsumit vjetor mbi 500 MWh dhe që e kanë zgjedhur furnizuesin fillon më datë 01.07.2017.



Menaxhmenti energjetik - nevojë dhe kërkesë e botës bashkëkohore

Menaxhmenti i suksesshëm sot përfshin edhe menaxhmentin e energjisë

Duke pasur parasysh se lëndët djegëse fosile janë gjithnjë më të rralla dhe më të shtrenjta, shtetet vazhdimisht duhet përballen me sfida për realizimin e njëkohshëm të qëllimeve për rritjen ekonomike dhe qëllimet për reduktimin e gazeve serrë. Kjo është konfirmuar edhe në raportin e "McKinsey" nga viti 2009. Në kushte të tilla, qëllimet që kompanitë presin t'i realizojnë përmes programeve të tyre të energjisë, janë të përcaktuara dhe në nivel ndërkombëtar. Për këtë qëllim, është nënshkruar edhe marrëveshja për trajtim të ndryshimeve klimatike COP21 në Samitin e 21 për Ndryshimet Klimatike të Kombeve të Bashkuara dhe është vendosur standardi ISO 50001, i cili parashikon zbatimin e sistemeve të menaxhmentit energjetik në kompanitë. Ky dhe standardet e tjera që kanë të bëjnë me punën energjetike janë me interes të veçantë për kompanitë që aspirojnë të bëhen pjesë e zinxhirit global të furnizimit.

Edhe pse rrjedh nga nevoja globale për kursimin e energjisë, menaxhmenti energjetik ofron një potencial të rëndësishëm për të përmirësuar punën e kompanive në disa segmente dhe është i zbatueshëm dhe i rëndësishëm edhe për kompanitë në Republikën e Maqedonisë. Menaxhmenti energjetik është një mjet i avancuar për racionalizimin e konsumit të energjisë elektrike, në segmentin e organizimit të punës dhe proceset teknologjike. EVN Maqedoni Elektrofurnizimi është kompania e parë në Maqedoni që klientëve të saj ua ofroi këtë mjet si një know-how i rëndësishëm në tregun bashkëkohor. Zbatimi i menaxhmentit energjetik fillon nëpërmjet revizionit energjetik, me çka bëhet gjetja dhe detektimi i të gjitha të ashtuquajturave



“pika të dobëta”, ku ka shpenzim të madh të panevojshëm të energjisë, që me zbatimin e disa mjeteve të caktuara organizative dhe me ndryshim të proceseve teknologjike mund të reduktohet në mënyrë të konsiderueshme. Përveç qasjes strategjike dhe organizative, shumë i rëndësishëm është edhe implementimi praktik i menaxhmentit energjetik në kompanitë. Në përgjithësi, gjatë zbatimit të menaxhmentit energjetik së pari fillohet me shqyrtimin e situatës aktuale në furnizimin dhe shfrytëzimin e energjisë. Sa

më shumë të dhëna të shumënumërta dhe më të detajuara ka në dispozicion, aq më mirë. Pastaj, përmes një analize adekuate të të dhënave përcaktohen mundësitë për kursime, ndërsa zakonisht më të dukshme janë humbjet rutinore të energjisë. Procesi nuk përfundon me ndërmarrjen e aktiviteteve të nevojshme për përdorimin e mundësive të identifikuar për kursime. Kontinuiteti në procesin e menaxhmentit energjetik sigurohet nga monitorimi i rezultateve të përpjekjeve të ndërmarra.








Cilat janë përfitimet për kompanitë nga menaxhmenti energjetik?

- Përmirësimi i rezultateve financiare
- Reduktimi i konsumit të energjisë
- Mbatja e regjistrimit për shfrytëzimin e energjisë, ofron mundësinë për planifikimin e nevojave të energjisë
- Menaxhmenti energjetik, si pjesë e politikës më të gjerë të përgjegjësisë shoqërore korporative, mundëson përmirësimin e imazhit të kompanisë që në afat të gjatë do të ndikojë në krijimin e avantazhit konkurrues.

Menaxhmenti energjetik është një parim i dobishëm dhe i zbatueshëm që u mundëson kompanive reduktim të harxhimeve të energjisë elektrike dhe rritje të konkurrancës në tregjet. Në Maqedoni, ka kompani që kanë zbatuar menaxhmentin energjetik dhe rezultatet në të vërtetë janë imponante, për të cilat do të ketë më shumë informacione në numrat e ardhshme.

Qasja në menaxhmentin energjetik në një kompani varet nga madhësia dhe nevojat e saj, si dhe prej industrisë të cilës i takon kompania. Megjithatë, ka shumë mënyra të kursimit të energjisë elektrike, të cilat mund të zbatohen në të gjitha kompanitë, pavarësisht nga industria e tyre. Zbatimi i menaxhmentit energjetik varet edhe nga kultura organizative e kompanisë. Për krijimin e një kulture që do të mbështesë zbatimin e suksesshëm të menaxhmentit energjetik, angazhimi i njerëzve të parë të kompanisë ka rëndësi të madhe.

Ndajmë me ju disa këshilla të dobishme për kursimin e energjisë elektrike, që do t'ju ndihmojnë t'i zvogëloni harxhimet e energjisë elektrike të biznesit tuaj - <https://www.snabduvanje.mk/Energy-efficiency/Energy-efficiency-in-business.aspx>



ING. GÜNTER BRAMBÖCK, ZËVENDËS-KRYETAR PËR ÇËSHTJE RREGULLATIVE NË NJËSINË AFARISTE TË EVROPËS JUGLINDORE, EVN AG

Besueshmëria në partneritetin e singërtë mbetet faktor kyç edhe në tregun e liberalizuar



Tregjet kombëtare shpesh jo vetëm që janë shumë të vogla, por nuk mund të jenë konkurruese, sepse prodhuesit që dominojnë në treg janë kryesisht në pronësi të shtetit. Prandaj, tregu kërkon integrim shumëkombësh, harmonizim dhe organizim.

→ Grupacioni EVN që nga fillimi ka marrë pjesë në krijimin e tregut të vetëm evropian për gaz dhe energji elektrike, që ka për qëllim krijimin e kushteve të barabarta për të gjitha vendet anëtare të BE-së, më shumë zgjedhje dhe shërbime më konkurruese për konsumatorët dhe të gjitha kompanitë energjetike. Si do t'i përshkruani përvojat e tregut të lirë nga perspektiva e sotme?

Qëllimi i politikës energjetike të BE-së në 25 vitet e fundit ka qenë krijimi i tregut të përbashkët konkurrues evropian për energji elektrike dhe gaz natyror. Me zbatimin e Ligjit për Energjetikë të BE-së, dallimet e mëdha në strukturën e kësaj industrie në shtetet anëtare u bënë të dukshme. Në disa shtete anëtare parakushtet për krijimin e konkurrencës ishin të favorshme, ndërsa në vende të tjera integrimi i fortë në zinxhirin e furnizimit i bëri të domosdoshme përcaktimin dhe gjetjen e roleve të reja dhe përgjegjësi në procesin e ndërlikuar. Tregjet likuide janë paraqitur relativisht shpejt për disa produkte themelore të energjisë në tregjet e mëdha kombëtare, që e ka shtyrë zhvillimin më tutje. Në rajonet më të fragmentuara, pozitat politike, ligjore dhe strukturore e kanë shmangur integrimin e tregut. Për të qenë konkurrues, tregu i energjisë elektrike duhet të jetë shumë më i madh se sa tregu kombëtar, veçanërisht për produktet më të rëndësishme energjetike, që të jetë likuid dhe të qëndrueshëm. Kjo është e domosdoshme sepse energjia elektrike nuk mund të ruhet dhe janë të nevojshme produkte të veçanta për të siguruar fleksibilitet dhe për të përshtatur kërkesën dhe prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme. Tregjet kombëtare shpesh jo vetëm që janë shumë të vogla, por nuk mund të jenë konkurruese, sepse prodhuesit që dominojnë në treg janë kryesisht në pronësi të shtetit. Prandaj, tregu kërkon integrim shumëkombësh, harmonizim dhe organizim. Në këtë drejtim, ka ende shumë detyra për t'u plotësuar në vitet e ardhshme.

→ Cilat janë trendet e reja në tregun e energjisë dhe çfarë mund të presin kompanitë dhe konsumatorët nga kjo?

Gjatë javëve të fundit u ratifikua seti i parë i rregullave për tregun e përbashkët evropian të energjisë. Kjo është arritja e parë dhe shumë e rëndësishme në harmonizimin e standardeve për të arritur një integrim më të mirë të tregut. Hapi i ardhshëm do të jetë harmonizimi i politikës energjetike në vendet e ndryshme që janë pjesë e tregut të përbashkët të brendshëm. Integrimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë do të jetë një sfidë e madhe, sepse shumica e teknologjive në dispozicion, të tilla si era dhe sistemet diellore kërkojnë

më shumë fleksibilitet, jo vetëm në instalimet ekzistuese të prodhimit, por edhe në anën e blerësit. Balancimi do të kërkojë investime shtesë dhe të shtrenjta. Në pjesën e Evropës jugore dhe juglindore, ndikimi ekzistues social do të bëhet një tjetër problem për balancim. Qytetarët kanë tendencë për ndikim më të vogël të prodhimit të energjisë elektrike mbi ambientin jetësor, por kjo nuk vjen falas. Nga ana tjetër, kjo mund të paraqesë mundësi të rëndësishme për të siguruar punësim më të madh dhe rritje të standardit jetësor.

→ Maqedonia është në fazën përfundimtare të procesit të liberalizimit dhe më shumë se 70% të energjisë që e shfrytëzon kjo industri, furnizohet nga tregu i lirë. Cilat janë përfitimet për kompanitë në procesin e liberalizimit?

Siç ishte e zakonshme në Evropën Perëndimore, biznesi sektori ka qenë pak a shumë apo diku edhe ende është i detyruar t'i subvencionojë amvisëritë në mënyrë të ndërlidhur përmes rregullimit të çmimeve. Së paku sa i përket energjisë, kjo do të ndryshohet në mjedisin konkurrues. Për ata me konsum të vazhdueshëm, çmimi do të jetë më i favorshëm. Për konsumatorët afarist me kërkesë të lartë në periudhën pik (periudha e ditës kur çmimi i energjisë elektrike është me i shtrenjtë në bursë) të lidhur me konsumin e ulët të përgjithshëm të energjisë elektrike madje mund edhe të shtrenjtohet. Kështu që unë rekomandoj menaxhim me ngarkimin atje ku energjia elektrike përdoret për ngrohje, për shembull, në restorante. Konsumatorët që janë në gjendje ta pasqyrojnë strukturën e harxhimeve për prodhimin e energjisë elektrike do të kenë më shumë përfitime nga tregu i liberalizuar.

→ EVN Elektrofurnizimi, që është pjesë e Grupacionit EVN, është një nga furnizuesit më të mëdhenj në tregun e hapur. Duke pasur parasysh se EVN Elektrofurnizimi

është pjesë e një grupacioni me përvojë të madhe në tregjet e hapura, çfarë domethënie ka për kompanitë dhe për zhvillimin e tregut në përgjithësi? A marrin kompanitë në tregun e hapur vlerën e shtuar?

Me hapjen e tregut, veçmë pamë se çmimet për konsumatorët afarist ulen. Megjithatë, çmimi gjithnjë e më shumë do ta reflektojë formën e ngarkesës, siç përmenda më lartë. Hapi i ardhshëm do të jetë shtimi i ekspertizës për të ndihmuar biznesin ndaj sigurisë së ardhshme të furnizimit dhe optimizimit të harxhimeve. Në përgjithësi, është e nevojshme më shumë energji elektrike për të arritur efikasitet më të madh në proceset e brendshme. Në çdo rast, besueshmëria në partneritetin fer do të mbetet kyçe për bashkëpunim të frytshëm.

→ Në cilin drejtim do të zhvillohet tregu i hapur në Maqedoni dhe kur mund ta presim integrimin e saj në tregun e hapur rajonal dhe evropian?

Duhet t'i jepet prioritet përmirësimit të vazhdueshëm të efikasitetit energjetik për të gjithë konsumatorët e energjisë elektrike. Çështje kritike mund të bëhet kërkesa e lartë në periudhën pik. Kalimi nga ngrohja me energji elektrike në ngrohje me gaz natyror ose ngrohje qendrore mund ta zvogëlojë kërkesën maksimale gjatë periudhave të ftohta dhe nevojën për importim kur energjia elektrike është e rrallë edhe në tregun rajonal.

Integrimi i mëtejshëm i tregut është kryesisht i varur nga organizimi solid i tregut, por jo vetëm kaq. Përshtatja e ligjeve, aspektet tatimore, sigurimet sociale, harmonizimi i politikave dhe kështu me radhë, duhet të zgjidhen në të gjitha vendet. Por kjo nuk është sfidë vetëm për Maqedoninë dhe vendet fqinje, por paraqet detyrë të vështirë për shumë rajone të tjera në Evropë.



Përvoja e konsumatorëve të kënaqur



Që nga fillimi i liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, më shumë se 200 konsumatorë kanë pasur mundësi që të binden në stabilitetin dhe besueshmërinë e EVN Maqedoni Elektrofurnizimi si një partner, dhe në cilësinë e shërbimeve tona. Në funksion të konfirmimit të saktësisë së

zgjedhjes së bërë, por edhe në funksion të lehtësimit të vendimit të kompanive që në periudhën e ardhshme do të duhet të zgjedhin furnizues përmes të cilit do të plotësojnë nevojat e tyre për energji elektrike, në këtë edicion të „EVN Zhurnal“ ju përcjellim përvojën e disa prej konsumatorëve tanë.

„Gjatë zgjedhjes së furnizuesit të energjisë elektrike, për ne ishte e rëndësishme që të kemi një partner të sigurt që do të na mundësojë shërbime të shkëlqyeshme, me ekip profesional me përvojë në të cilin ne mund të mbështetemi. EVN Elektrofurnizimi në këtë drejtim ka përbushur dhe tejkaluar pritjet tona, duke na udhëhequr gjatë ndryshimeve që i ka sjellë liberalizimi i tregut dhe duke na ndihmuar në sjelljen e vendimeve që kanë krijuar vlerë për kompaninë tonë. I rekomandojmë për çdo kompani që ka për qëllim të ndërtojë marrëdhënie partnerike vërtetë efikase, stabile me furnizuesin e saj. „

IGM Trejd

„Liberalizimi i tregut ka sjellë disa përfitime, por edhe sfida. Falë ekipit të EVN Elektrofurnizimi gjithmonë ishim të informuar në kohë dhe të gatshëm që të mund shpejt dhe në mënyrë efikase të përshtatemi dhe të sigurojmë një pozitë më të mirë për kompaninë. Njohja e rrethanave të tregut, reagimi i shpejtë dhe përpikshmëria në realizimin e nevojave, tona paraqesin një vlerë të shtuar të shkëlqyeshme për ekipin tonë. I vlerësojmë shumë lartë si furnizuesit tanë dhe u'a rekomandojmë EVN Elektrofurnizimi secilit që kërkon një bashkëpunim të qëndrueshëm dhe efikas. EVN Elektrofurnizimi jo vetëm që siguron furnizim të qëndrueshëm dhe të pandërprerë me energjensin kryesor për procesin tonë të punës, por edhe ekipi i tyre ka aftësi për të parë gjërat nga perspektiva e klientit, duke na kursyer kohë dhe para. „

Shparkase Banka Maqedoni SHA Shkup

„Momenti në të cilin lidhëm marrëveshje me EVN Elektrofurnizimi e ka përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme menaxhmentin energjetik në kompaninë tonë. Menaxherin për klientë kryesorë e llogarisim si pjesë të ekipit tonë. Ata në përgjithësi i kanë përbushur pritjet tona dhe paraqesin një partner të qëndrueshëm dhe të besueshëm që na jep mbështetje në momentet kyçe. Falë mbështetjes që e kemi marrë në lidhje me menaxhimin e aktiviteteve të lidhura me energjinë elektrike, kemi pasur mundësi më shumë të fokusohemi në zhvillimin strategjik të biznesit tonë. Nga bashkëpunimi i deritanishëm me EVN Elektrofurnizimi mund të konstatojmë se marrim një shërbim superior me një çmim konkurrues, me një staf që është sipërmarrës dhe mund t'ia del mbanë me nevojat e biznesit tonë. „

KAM SHPK Shkup



Ueb-faqja e re e internetit për avancimin e përvojës së konsumatorëve

EVN Elektrofurnizimi me kënaqësi e lajmëron vënien në shfrytëzim të versionit të ri të ueb faqes sonë www.snabduvanje.mk, e cila është dizajnuar në mënyrë që përveç si pasqyrim i shërbimeve të EVN Elektrofurnizimi dhe kontaktit me kompaninë, konsumatorëve aktual dhe potencial mund t'u shërbejë si ueb-burim kryesor dhe portal për informacione të përgjithshme në lidhje me energjinë elektrike.

Në faqen e re të internetit, kompanitë drejtpërdrejt mund t'i kontaktojnë menaxherët për klientë kryesorë për të kërkuar shërbime specifike, këshilla ose oferta. Gjithashtu, lehtësisht mund t'i gjejnë informacionet më të rëndësishme për ta, siç janë: shpjegimi i faturës tonë, legjislacioni energjetik, dokumente për shkarkim etj. Përveç kësaj, faqja e internetit jep mesazh të qartë për vlerat që ua ofrojmë klientëve si partnerë tanë afatgjatë.



www.snabduvanje.mk

